



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-252

13.09.2024

Shkup

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4, dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin, 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.08-219 datë 26.08.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO – FM SHPK Gostivar dhe Konkluzionin ark.nr.02-3712/4 datë 12.09.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 35-të mbajtur më 12.09.2024, miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) sipas nenit të cituar të ligjit, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesve me përfundimin e vlefshmërisë së lejes në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 33-të mbajtur më 20.08.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3508/2 datë 26.08.2024, miratoi Vendim PA1 nr.08-219 datë 26.08.2024 me të cilin i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023, përshkak se pas dhënies së lejes janë paraqitur rethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes ta kryejë veprimtarinë, respektivisht përshkak se edhe në afatin shtesë nuk i ka përbushur detyrimet ligjore dhe në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën pronësore, redaktorin

përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, realizimin e të hyrave të përgjithshme dhe shpenzimeve dhe sigurimin e veprimtarisë në vitin 2023 dhe për ndëgjueshmërinë mesatare në vitin 2023.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastuar), Vendimin PA1 nr.08-219 datë 26.08.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3712 datë 12.09.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 35-të mbajtur më 12.09.2024, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.